



**Republika e Shqipërisë**  
**Universiteti i Sporteve të Tiranës**  
**Rektorati**

Tiranë, më 21.09.2017

**Njoftim**

**Për aplikimin në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, Programi i Studimit “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, me kohë të plotë, pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në UST.**

Në UST, pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit fillojnë aplikimet për një Program të ri Studimi “Menaxhim në sport dhe turizëm” në ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, me kohë të plotë.

Aplikimet e kandidatëve kryhen pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit në datat **25 Shtator 2017 deri 20 tetor 2017**, nga ora 8<sup>00</sup> deri 15<sup>00</sup>.

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon në sekretarinë mësimore, dokumentacionin sic është përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 18, dt. 16. 08. 2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017 "për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 -2018", Kreu VI/4

Kanë të drejtë të aplikojnë kandidatë që kanë përfunduar studimet:

- Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes të UST-së.
- Bachelor në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit të UST-së.
- Bachelor në Shkenca Sportive në institucione të tjera të arsimit të lartë brënda dhe jashtë vendit.
- Kandidatë nga institucione të menaxhimit të sportit dhe turizmit sportiv (shoqata, federata, klube sportive) që kanë përfunduar studime në shkencat sportive.

Gjithashtu kanë të drejtë të aplikojnë kandidatë që kanë kryer studime bachelor, në programe studimi të shkencave ekonomike, në institucione të tjera të Arsimit të Lartë. Këta kandidatë do të shlyejnë 5 kredite nga shkencat sportive.

Kriteret që do të plotësojnë kandidatët janë kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Nr. 6, dt. 19.01.2017, për ciklin e dytë të studimeve Master Professional.

Tarifa e aplikimit për programet e studimit të ciklit të dytë është **2500 lekë**.

Fleta “Faturë Arketimi”, me të cilën kandidati do të paraqitet në banke për të bërë pagesën e tarifës, mund të shkarkohet nga faqja Web e UST nga vetë kandidati.

Informacion i plotë për aplikimet dhe regjistrimet, për udhëzimin e MAS nr. 18, dt. 16.08.2017, vendimin e Rektorit për aplikimet gjendet në faqen Web të UST dhe pranë sekretarive mesimore.

**Prof. Dr. Agron CUKAJ**  
**REKTOR**

